

VENDIM
Nr. 7, datë 6.2.2014

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË KURUM INTERNATIONAL SHA, PËR
TRANSFERIMIN E ASETEVE TË HEC “ULËZ”-“SHKOPET”, “BISTRICA 1” DHE “BISTRICA 2” NË
KUADËR TË MARRËVESHJES ME “IFC”, “BANKA KOMBËTARE TREGTARE SHA”, “BLACK
SEA TRADE AND DEVELOPMENT BANK” AND “RAIFFEISEN BANK SHA”**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20, pika 1, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 8 të “Rregullores të procedurave e të transferimit të aseteve të të licencuarve”, si dhe pikave 1.3 dhe 1.6 të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e datës 6.2.2014, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti rezulton se janë plotësuar sipas kërkesave ligjore pikat si më poshtë:

- Neni 7, pika 1.1 dhe 1.2

Emri dhe adresa e plotë e të licencuarit:

- Neni 7, pika 1.3/ “a”, “b”

Përshkrimi i të licencuarit dhe informacioni lidhur me aktivitetin e tij.

Neni 7, pika 1.3 “c”

“Gjendja financiare në kohën kur paraqitet kërkesa dhe efekti i pritshëm pas transferimit të aseteve.

Janë plotësuar gjithashtu pika 1.3/ “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, të nenit 7 të Rregullores:

- Pika 1.3/ “d” – Përshkrimin e kandidatit përfitues.

- Pika 1.3/ “e”-Arsyet dhe shkaku ligjor i barrësimit-motivet.

- Pika 1.3/ “f”-Efektet e pritshme të transferimit (dhënies peng/hipotekë) në aktivitetin e të licencuarit.

- Pika 1.3 “g” – Efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarfiat e aktivitetit të licencuar.

- Pika 1.3 “h” - Marrëveshjet paraprake.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën nr. 87, prot, datë 20.1.2014, të shoqërisë “Kurum International sh.a.” për transferimin e aseteve të HEC “Ulëz”-“Shkopet”, “Bistrica 1” dhe “Bistrica 2” dhe miratimet e kërkuara në të, në kuadër të:

- Marrëveshjes së kushteve paraprake të datës 19.12.2013, lidhur me paketën siguruese të financimit, me përfitues kolateral “Raiffeisen Bank sh.a.” në rolin e agentit të kolateralit të huadhënësve kryesorë (“IFC”, “Banka Kombëtare Tregtare sh.a.”, “Black Sea Trade and Development Bank” and “Raiffeisen Bank sh.a.”), të rënë dakord nga palët në këtë dokument (në definicionin “Dokumentet e sigurisë”);

- Marrëveshjes së barrës siguruese mbi të gjitha asetet e luajtshme të preکشme, aktuale dhe të ardhshme, pjesë e HEC-eve të sipërpërmendura, në pronësi të “Kurum International sh.a.”

- Marrëveshjes së transferimit të të drejtave mbi licencën/at dhe kontratat e projektit dhe çdo të drejtë tjetër të “Kurum International sh.a.” sipas dokumenteve të projektit.

- Marrëveshjes hipotekore mbi të gjitha pasuritë e paluajtshme të “Kurum International sh.a.” pjesë e (i) HEC-eve të Bistricës 1 dhe Bistricës 2 dhe Ulëz-Shkopet dhe (ii) Fabrikës së Metalurgjisë së Çelikut, Elbasan;

- Marrëveshjes së kolateralit financiar mbi llogarinë bankare në zotërim të huamarrësit në të cilën do të paguhet:

a) të gjitha të ardhurat e sigurimeve të rëna dakord nga palët; dhe

b) të gjitha të ardhurat e pagueshme ndaj huamarrësit sipas dispozitave të projektit;

- Letrës së konfirmimit të ERE-s në përputhje me dakortësimin e palëve në marrëveshjen e kushteve paraprake të datës 19.12.2013, neni 8.16 dhe definicionin që i bëhet kësaj letre në këtë marrëveshje.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e shoqërisë “Kurum International sh.a.” për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti